REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 917-931 120
Datë/Datum. 15.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

**PSH.nr.917/20**
**931/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenkovic – Kryetar , z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: N.T.SH "Node Tech"-Suharekë, dhe grupi i OE: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,-Suharekë, kundër njoftimit për kontratë, ku është rekomanduar për kontratë OE: "Cimi Electronic"SH.P.K-Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje teknologjike, kompjutera, komplet, fotokopje, kamera të sigurisë, printera, videoprojektorë dhe pajisje tjera" , me nr. të prok: 624-20-5060-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Suharekë", më datën: 15.12.2020, mori këtë:

## VENDIM

**I.APROVOHEN**, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: N.T.SH "Node Tech"-Suharekë, dhe grupi i OE: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,-Suharekë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje teknologjike, kompjutera, komplet, fotokopje, kamera të sigurisë, printera, videoprojektorë dhe pajisje tjera", me nr. të prok: 624-20-5060-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Suharekë".

**II.ANULOHET,** njoftimi për dhënie te kontrates i Autoritetit Kontraktues, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje teknologjike, kompjutera, komplet, fotokopje, kamera të sigurisë, printera, videoprojektorë dhe pajisje tjera", me nr. të prok: 624-20-5060-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Suharekë", dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: N.T.SH "Node Tech"-Suharekë, dhe grupi i OE: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,-Suharekë, i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI** .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: N.T.SH "Node Tech"-Suharekë, dhe grupi i OE: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,-Suharekë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 10.11.2020 me nr. 917/20 ,dhe me 13.11.2020 me nr. 931/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje teknologjike, kompjutera, komplet, fotokopje, kamera të sigurisë, printera, videoprojektorë dhe pajisje tjera" , me nr. të prok: 624-20-5060-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Suharekë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 28, si dhe nenin 59 të LPP-së , te ankesa me nr. 917/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 56.3 , 59 , si dhe nenin 60 të LPP-së, te ankesa me nr. 931/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore, ankesën P.Sh nr. 917/20, si dhe me datë 18.11.2020 P.Sh nr. 931/20

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: P.Sh nr. 917/20, si dhe me datë 30.11.2020 ankesën P.Sh nr. 931/20.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES :" N.T.SH "Node Tech"-Suharekë,

**Pretendimi Ankimor nr. 1** Kerkesa1- Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. Për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat ne vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shume me shume dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është diçka e pa qarte ne listën dhe dëshmi conform nenit 72 te LPP-se është dashur me kërkua sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej: 4,942.50 euro.

**Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 1** Bazuar ne Ofertën e OE Node Tech përkatësisht Listës se Kontratave/referencave te ofruar rezulton se Kontrata e ofruar dhe Referencat e plotësojnë kriterin sipas dosjes se Tenderit. Andaj konsideroi se ky pretendim është i Bazuar

**Pretendimi Ankimor nr. 2** Kërkesa2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku -Një(1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit. Ne këtë pike fillimisht nuk keni kërkuar Inxhinier te diplomuar, po vetëm inxhinier , përkundër kësaj për këtë pike ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha I cili me dëshmitë e tije I plotëson kërkesat e FDT-se. NE CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron ne liste siç është kërkuar, nëse e keni patuar te pa qarte dhe këtë pike është dashur conform nenit 72 te LPP-se te kërkoni diplomën Master te cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej 4,942.50 Euro Pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jone, për piken e inxhinier te elektronikes për te cilën jemi eliminuar, çuditërisht ne Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier I Shkencave Kompjuter, për te cilën pike ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për te cilën vete AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjese e ofertës tone!!!

**Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.** Bazuar ne dokumentet e dosjes se Ofertës për z. Xhevat Berisha te njëjtit kane ofruar dokumentacion si: Diplome Bachelor i Shkenca te Inxhinierisë Elektrik ku i njëjti mbanë datën e diplomimit me date 03 dhjetor 2013 ne Departamentin Elektronike, Bazuar ne kërkesat se dosjes se Tenderit: Kërkesa2 – Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku –Një (1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit Një ( 1) Inxhinier i shkencave kompjuterike ,se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia2 - Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV.

Rezulton se i njëjti nuk përmbush kërkesën e AK-se pasi nuk plotëson kriterin baze sepse ka Gradën Bachelor dhe jo Inxhinier ashtu siç edhe kërkohet ne Kërkesën e AK-se. Në lidhje me këtë pretendim Ankimore OE do te duhej te parashtronte kërkesë për sqarime shtese gjate fazës se

Njoftimit për kontrate dhe jo vetëm pas vlerësimit te Ofertave. Andaj konsideroi se ky pretendim është i paqëndrueshëm.

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,**-Suharekë,

**Pretendimi Ankimor nr. 1** Si pale me interes juridik e material sipas nenit 4.1.26 te LPP-se,brenda afatit ligjore te parapare ne nenin 108/A, parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim. Me date: 29.10.2020, pranuam vendimin dhe letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilën ju keni dhënë arsyetimin se ne nuk e përmbushim kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. arsyetimi i dhënë ne letrën standarde është krejtësisht i paqëndrueshëm, për faktin se te gjitha dëshmitë e ofruara janë ne përputhje te plote me kërkesat e DT-se dhe pretendimi juaj se nuk i përmbushim kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional janë ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se, sepse dëshmitë janë ne sipas kërkesave te parapara ne kërkesë te dosjes se tenderit nuk keni kërkuar qe ISO standardi te jetë i ndonjë fushe përkatëse, konkretisht keni kërkuar qe OE te jetë i certifikuar me ISO standard 9001:2015 dhe çdo tentativë e juaja për te dal nga kjo kërkesë është ne kundërshtim te hapur me paragrafin 3 te nenit 56 ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

**Përgjigje ne pretendimin Ankimor nr. 1** Bazuar ne Ofertën e OE AFA-ING;"K-ING" sh.p.k përkatësisht ISO Standard 9001:2015. OE ne fjale ka ofertuar me ISO Standard 9001:2015, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave; Rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimi i impianteve për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve dhe urave. Ndërsa Projekti ne fjale ka te beje me Furnizim me Pajisje te TI-se, gjë qe një Standard i tille i ofruar nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin, andaj konsideroi se ky ISO Standard i ofruar nuk plotëson kërkesat për këtë projekt.

**Pretendimi Ankimor nr. 2** Sa i përket arsyetimit tuaj se nuk kemi ofruar dëshmitë lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike, kërkojmë nga ju te verifikoni edhe një here sepse dëshmia lidhur me këtë inxhinier gjendet ne ofertën tone te dorëzuar ne sistemin e e-prokurimit. dëshmitë për këtë inxhinier janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

**Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.** OE ne fjale rezulton se për këtë projekt ka ofruar stafin si ne vijim: Ardian Morina – Diplome e ciklit te pare te Studimeve Universitare Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT Bilbil Haxhijaha –Bachelor of science Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT Florim Morina – Bachelor i shkencave te inxhinierisë elektrike Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT, Izet Buzha – Inxhinieri i diplomuar I Elektronikes Florian Mucolli- bazuar ne CV e te njëjtit dhe dokumenteve përcjellëse rezulton se: Posedon diplome Bachelor

ne drejtimin: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike November 2012 (ëorking on Master Thesis) – nuk ka dëshmi se ka te përfunduar Master Konsideroi se ne lidhje me këtë AK do duhej conform nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese për dëshmitë e te njëjtit pasi ne dosjen e ofruar nuk ka Diplome Master, mirëpo ne CV ceket: November 2012 (ëorking on Master Thesis).

**Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.11.2020 me raportin e ekspertizës, te ankesa me nr. 917/20, ndërsa me date 30.11.2020 te ankesa 931/20.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 23.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik.

Operatori Ekonomik: N.T.SH "Node Tech"-Suharekë, me datë 19.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: N.P.SH "Afa-Ing & K-Ing" SH.P.K,-Suharekë, me datë 03.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar, Me date 30.11.2020 pranuam raportin e ekspertizës te cilin e kundërshtojmë ne tërësi pasi qe i njëjti nuk i ka trajtuar pretendimet tona siç është i obliguar me nenin 113 te LPP ,një raport i tillë i eksperti diskriminues dhe i njëanshëm Ne i plotësojmë ne tërësi kërkesat e AK-se dhe jemi te përgjegjshëm Ne kemi ngarkuar iso certifikatën dhe diplomën e ing te elektronikes prova te cilat nuk janë trajtuar nga ekspertit juaj prove bashkangjitur gjeni shkresat e ngarkuara ne attach,dhe te njëjtat i keni ne e prokurim. Sa i përket iso certifikatës ne edhe ne ankesë e kemi potencuar se AK nuk ka përcaktuar veprimtarin megjithatë ne e kemi edhe te njëjtën AK ka mundur ta kërkoi përmes nenit 72 te LPP se. Përveç raportit jo profesional te ekspertit ne kemi dyshime serioze për anshmëri te ekspertit pasi qe OE i rekomanduar dhe eksperti janë nga i njëjti vend, ne kërkojmë caktim te seancës ne mënyrë qe ti japim argumentet tona dhe lënda te kthehet ne ri vlerësim ne te kundërtën ne obligohemi qe ti ndjekim rrugët tona ligjore ne organet tjera kompetente . Arsyetimin se eksperti shqyrtues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së, sepse i njëjti ka dal jashtë kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Ne dosje te tenderit te kapaciteti teknike dhe profesional është kërkuar ISO certifikata 9001:2015 te cilën e kemi dorëzuar ne ofertë ndërsa eksperti tani kërkon veprimtari adekuate e cila nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit, pra eksperti është ne kundërshtim flagrant me nenin 56.3 te LPP-së. Sa u

përket inxhiniereve ju lutem referojuni kërkesave te dosjes se tenderit ne lidhje me stafin. ne asnjë pike tek kërkesat për stafin NUK janë kërkuar gradat master siç pretendon eksperti. Prandaj kërkojmë nga paneli qe këto dy pika ti analizoj kërkesat e dosjes se tenderit dhe te marr vendim meritor lidhur me ankesën tone sepse dëshmitë janë sipas kërkesave te dosjes se tenderit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: " N.T.SH "Node Tech"-Suharekë**

Lidhur me pretendimin ankimor per Kërkesën 1 të dosjes së tenderit- Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve, ku për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat ne vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shume me shume dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është diçka e pa qarte ne listën dhe dëshmi conform nenit 72 te LPP-se është dashur me kërku sqarime e jo me dëmtuar buxhetin prej: 4,942.50 euro, paneli shqyrtues sqaron se bazuar ne ofertën e OE Node Tech përkatësisht Listës se Kontratave/referencave te ofruar rezulton se Kontrata e ofruar dhe Referencat e plotësojnë kriterin sipas dosjes se tenderit, andaj pretendimi ankimor është i qëndrueshëm andaj AK te kërkoj sqarime shtese lidhur me këtë kërkesë konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket kërkeses 2 të dosjes së tenderit ku OE ankues deklaron se ne këtë pike fillimisht nuk kanë kërkuar Inxhinier te diplomuar, po vetëm inxhinier, përkundër kësaj për këtë pike ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha i cili me dëshmitë e tij i plotëson kërkesat e FDT-se dhe ne CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron ne liste siç është kërkuar, nëse e keni patur te pa qarte dhe këtë pike është dashur konform nenit 72 te LPP-se te kërkoni diplomën Master te cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtu buxhetin prej 4,942.50 Euro, ku pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jone, për piken e inxhinier te

elektronikes për te cilën jemi eliminuar, çuditërisht ne Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier i Shkencave Kompjuter, për te cilën pike ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për te cilën vete AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjese e ofertës tone. Paneli shqyrtues sqaron se në ne dosje te tenderit perkatesisht kërkesën 2 është kërkuar: Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku -Një(1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit.

Bazuar ne dokumentet e dosjes se ofertës se OE ankues për z. Xhevat Berisha te njëjtit kane ofruar dokumentacion si: Diplome Bachelor i Shkenca te Inxhinierisë Elektrik që mbanë datën e diplomimit me date 03 dhjetor 2013 ne Departamentin Elektronike, andaj duke pasur për bazë kërkesat e dosjes se tenderit ku si dëshmi është kërkuar Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV, rezulton se i njëjti nuk përmbush kërkesën e AK-se pasi nuk plotëson kriterin baze sepse ka Gradën Bachelor dhe jo Inxhinier ashtu siç edhe kërkohet ne Kërkesën e AK-se. OE do te duhej te parashtronte kërkesë për sqarime shtese gjate fazës se Njoftimit për kontrate e jo vetëm pas vlerësimit te ofertave, andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ANKUES: N.T.SH "Afa-Ing & K-Ing"SH.P.K,-Suharekë,**

OE ankues në ankesën e tij ka deklaruar se si pale me interes juridik e material sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, brenda afatit ligjore te parapare ne nenin 108/A, parashtruam kërkesë për rishqyrtim. Me date: 29.10.2020, pranuam vendimin dhe letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilën ju keni dhënë arsyetimin se ne nuk e përmbushim kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Arsyetimi i dhënë ne letrën standarde është krejtësisht i paqëndrueshëm, për faktin se te gjitha dëshmitë e ofruara janë ne përputhje te plote me kërkesat e DT-se dhe pretendimi juaj se nuk i përmbushim kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional janë ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se, sepse dëshmitë janë ne sipas kërkesave te parapara ne kërkesë te dosjes se tenderit nuk keni kërkuar qe ISO standardi te jetë i ndonjë fushe përkatëse, konkretisht keni kërkuar qe OE te jetë i certifikuar me ISO standard 9001:2015 dhe çdo tentativë e juaja për te dal nga kjo kërkesë është ne kundërshtim te hapur me paragrafin 3 te nenit 56 ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues pasi që analizoj pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se bazuar ne Ofertën e OE AFA-ING;"K-ING" sh.p.k përkatësisht ISO Standard 9001:2015. OE ne fjale ka ofertuar me ISO Standard 9001:2015, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave; Rrjete të ujësjellësit dhe

kanalizimeve, ndërtimi i impianteve për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve dhe urave, ndërsa projekti ne fjale ka te beje me Furnizim me Pajisje te TI-se, gjë qe një standard i tille i ofruar nga OE nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin, andaj duke pasur parasysh këtë fakt dhe mendimin e dhënë nga eksperti teknik paneli shqyrtues vlerëson se ky ISO Standard i ofruar nuk plotëson kërkesat për këtë projekt, AK te kërkoj sqarime shtese lidhur me këtë kërkesë konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

OE ankues pretendon se arsyetimi se nuk kemi ofruar dëshmitë lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike nuk është i qëndrueshëm dhe kërkojmë te verifikoni edhe një here sepse dëshmia lidhur me këtë inxhinier gjendet ne ofertën tone te dorëzuar ne sistemin e e-prokurimit. dëshmitë për këtë inxhinier janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit, paneli shqyrtues sqaron se në shkresat e lëndës shihet se OE ne fjale rezulton se për këtë projekt ka ofruar stafin si ne vijim: Ardian Morina – Diplome e ciklit te pare te Studimeve Universitare ndërkaq në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT Bilbil Haxhijaha – Bachelor of science. Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT. Florim Morina – Bachelor i shkencave te inxhinierisë elektrike, ndërkaq në dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT. Izet Buzha – Inxhinieri i diplomuar i Elektronikes Florian Mucolli- bazuar ne CV e te njëjtit dhe dokumenteve përcjellëse rezulton se: posedon diplome Bachelor ne drejtimin: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike November 2012 (ëorking on Master Thesis) – nuk ka dëshmi se ka te përfunduar studimet master. Paneli shqyrtues vlerëson se AK do duhej konform nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese për dëshmitë e Florian Mucolli pasi ne dosjen e ofruar nuk ka Diplome Master, mirëpo ne CV ceket: November 2012 (working on Master Thesis).

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më

transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIĆ

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 /AK/ - "KK-Prizren",

1x1 / OE/ -N.T.SH "Node Tech"-Suharekë,

1x1 /OE/: N.P.SH "Afa-Ing & K-Ing "SH.P.K-Suharekë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.